

KOSONIA

Ballina: Melinda Zuka-Ahmeti

Fenomeni
Luiz Ejlli

Kush llogaritet
VIP në Kosovë

Hoxhallarët qajnë,
politikanët qeshin

**MELINDA
ZUKA-AHMETI**

*Biznesmene e zonja,
pozitive, grua e fortë*

Baŕte Shala
zbulon
personin
e zemrës

Fakulteti
nuk më shkoi,
bile me kanë
të martohem

Mevludja
6 burra i qoi
në Hamam
të Hyrës

Ndërmarrëset kosovare
takohen me bizneset
shqiptare në Gjermani,
“Unioni i Bizneseve
Shqiptare-Gjermane”
nikoqir i shkëlqyer

remos

DENTIFIX

eurokoha

BREZOVICA
WITKAM

allüre

UB
UNION BUSINESS

DINO
CERAMICHE

Shkabaj

KENOA
CENTER

SHERWOOD

Banaderm

MARITIM

CIMA



NE GJITHMONË E BËJMË IMAZHIN E
ARKITEKTURËS TË PËRSOSUR



 www.dinoqeramika.store



*Në ballinë:
Melinda Zuka-Ahmeti*

**Biznesmene
e zonja,
pozitive,
grua e fortë**

Në ballinë: Melinda Zuka-Ahmeti

“LIDA Beauty Center” në Zvicër është qendra e famshme e bukurisë dhe estetikës me pronare Melinda Zuka-Ahmeti, zonjë me botë të madhe, e dëshmuar për punën e saj profesionale, korrektësinë dhe aftësinë që posedon për ta bërë më të mirën në çdo aspekt. Melinda prej vitesh është me të dyja këmbët në botën e së bukurës, ku punon si dermopigmentologe, estetiste dhe grimere, e që para njëmbëdhjetë vjetësh ishte e angazhuar në fushën e kontabilitetit.

Çfarë ndodhi?

Pse bëri rokadë profesionale?

A është pishman apo e lumtur me zgjedhjen e re?

Për jetën e saj, punën dhe shumë të tjera, flet imazhi i këtij numri të “Kosovares”, Melinda Zuka-Ahmeti...

Lidë, na e përshkruaj veten me tri fjalë?

- Pozitive, e pavarur, e fortë.

E, të tjerët si të përshkruajnë?

- Pikërisht kështu siç e përshkruaj veten time dhe jam e lumtur të pasqyroj se kush jam në të vërtetë.



Cila ishte periudha më e bukur, më e ndritshme e jetës tënde?

- Nëse më duhet të kujtoj një periudhë të jetës sime, do theksoja periudhën ndërmjet moshës 18 dhe 22 vjeç, kohë kur familja ime ishte e plotë dhe ku të gjitha dyert ishin ende të aksesueshme pa asnjë kufizim.

Një kujtim që nuk fshihet?

- Si nënë, imazhi i parë që më vjen në mendje është ai i lindjeve të fëmijëve të mi. Por, në të 40-at, ne grumbullojmë shumë momente të paharrueshme.

Të flasim pak për avancimin tënd profesional?

- Sot jam në botën e bukurisë dhe

punoj dermopigmentologe, estetiste dhe grimere, por para 11 vjetësh isha e angazhuar në fushën e kontabilitetit. Por, një ditë vendosa ta braktis profesionin kontabiliste dhe të hapë biznesin tim. Dhe, nuk jam pishman, meqë sot e bëj me pasion punën që e dua.

Puna dhe biznesi yt kanë ecur shumë mirë. A ka një formulë suksesi?

- Nuk ka asnjë formulë magjike, përveçse ta duash thëllësisht atë që bën.

Aktualisht, cili është shërbimi më i kërkuar në qendrën tuaj?

- Absolutisht, secili prej shërbimeve të mia është shumë i kërkuar, sepse

parimi im është të plotësoj nevojat e klienteve të mia.

Pika jote e fortë në aspektin profesional?

- Natyrisht, kualiteti i punës sime, por edhe garancia që u jap klientëve për kualitetin e produkteve, e, gjithashtu, për faktin se puna ime përfundon me sukses.

Dhe, klientet e mia, natyrisht, qind për qind janë të kënaqura, pavarësisht kohës dhe numrit të seanceve.

Po ashtu, forca ime e madhe është se i trajtoj klientet ashtu siç do të kisha dëshirë t'më trajtojnë mua.

Diçka me të cilën nuk bën kompromis në aspektin profesional?

- Në qendrën time të bukurisë nuk bëhet fjalë t'i nënshtrohet një kliente një shërbim që nuk i nevojitet. E vlerësoj shumë ndershmërinë dhe, siç thashë më parë, dua dhe duhet t'i trajtoj ashtu siç kisha dashur t'më trajtojnë.

Duke qenë femër model, a ka më shumë pritshmëri nga rrethi dhe a është kjo një sfidë në vete?

- Jo, vërtet jo. Unë jam qind për qind vetvetja dhe mendoj se i përshtatet të gjithëve.

Kur lodhesh, çka të bën të ngrihesh sërisht?

- Dëgjoj muzikë. Bëj

sport. Këto gjëra më motivojnë shumë dhe e mendoj se jeta është e shkurtër.

Dukesh bukur. Sa investon në pamjen e jashtme?

- Faleminderit për kompliment! Pjesa e brendshme reflektohet edhe në pamjen e jashtme.

Ushqehem e ekuilibruar, nuk konsumoj pije të gazuara apo alkoolike. Pi tri litra ujë në ditë. Ushtror rregullisht.

Përndryshe, kujdesem për lëkurën, flokët, thonjtë. Gjëra që, pa dyshim, i bëjnë shumë femra.

A ndihmon aparenca edhe në punë?

- Po, pamja e jashtme luan një rol të rëndësishëm në fushën time, pa dyshim.

Jeta jote private?

- Ç'të them... Jam, thjesht, Melinda. Nëna e Leones, Elines dhe e Liamit. Më ka pëlqyer çdo periudhë e jetës sime. Bëhem një version më i mirë i vetes çdo vit.

Jam e rrethuar nga familja dhe miqtë e mi. Kjo është e rëndësishme, sepse, ashtu siç më pëlqen shpesh ta them: "Në mesin e pesë njerëzve që të rrethojnë, reflekton TI".

Për fund?

- U falënderoj që më keni parë si imazh-model në Revistën "Kosovarja". Suksese!

Nderim Neziri





Grumbull njerëzish
në pritje për viza
në ambasada

Hoxhallarët qajnë, *politikanët qeshin!*

Kosova po zbrazet si në vitet 90, kur regjimi i Millosheviqit largoi me dhunë qindra mijëra punëtorë, të cilët, në përpjekje për ekzistencë ia mësynë shteteve të Perëndimit, e që shumica prej tyre ndodhen edhe tash.

Shtrohet pyetja: Po tash, në Kosovën e lirë, pse njerëzit ikin nga Kosova?

Çdo ditë e më shumë lexojmë lajme se para ambasadave të Perëndimit në Prishtinë numër i madh i të rinjve, por edhe i moshave të tjera, e edhe i atyre që punojnë, presin për vizë. Presin që të marrin vizën dhe të ikin, kah sytë këmbët, siç thuhet në popull.

Pse, tash, në Kosovën e lirë?

Sepse të rinjtë s'po kanë perspektivë e as punësim. Fjala është për atë pjesë të popullatës e cila nuk merret me politikë. E, ata që merren me politikë gjejnë punë edhe brenda natës!

Se është kështu dëshmon më së miri rasti që u shkrua gjatë në portalet tona se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, emëroi këshilltar të tij Bekim Qokun, i njëzetekatërti këshilltar me radhë! E, ata që nuk merren me politikë, që janë

apolitik, presin para ambasadave për vizë, për të siguruar ekzistencën për vete dhe familjen e tyre...

POPULLI ETNIKISHT PO VARFËROHET

Ky titull del nga një debat i frikshëm politik në njërin nga televizionet tona, kur një bashkëbisedues tha se skamje në Kosovë, skamje në Shqipëri. Skamje etnike, tha ai. Se është kështu dëshmon e dhëna se nga Kosova, e edhe më shumë po ikin nga Shqipëria, sepse në këto dy vende jetë ka vetëm për politikanët, familjarët e farefisin e tyre...

Por, ajo që më preku shumë në shpirt është intervista në studion e TV7, me hoxhën nga Shipoli i Mitrovicës, Fatmir

Latifajn, i cili në moshë të re, në radhët e UÇK-së e kishte humbur shuplakën e dorës së djathtë në luftë kundër armikut.

Ai në pyetjen e gazetarit se cili është hidhërimi që ka pasur kohëve të fundit, tha: "Kohëve të fundit kam pasur rastin t'i vizitoj shumë fshatra të Drenicës dhe të Dukagjinit. E, ajo që më preku më së shumti në shpirt janë fshatrat e boshatisur, sepse të rinj e të moshuar i kanë braktisur shtëpitë e tyre, duke marrë udhën e kurbetit".

"Kosova nuk e meriton të braktiset!", tha ai dhe u zhgreh në vaj.

Shtrohet pyetja: Cili politikan do të qante pse Kosova po boshatiset?

Deri më sot nuk e pamë një të tillë!

Selim Rama

PENSIONISTI: KAH T'IA MBAJ, A JETOHET KËSHTU?!



Se populli i ka punët ngushtë, e dëshmon më së miri rasti i Musli Zeqirit, nga "Kodra e Trimave" në Prishtinë, i cili, pas 32 vjet punë, ditë më parë i mbushi 65 vjet dhe për ditëlindjen e tij shteti ynë e qerasi me largim nga puna!

"Nga 480 euro, sa i merrja në KEK, zbrita në 100 euro! Jam i vetmi bartës i familjes 8 anëtarësh. Gjashtë fëmijë, tre prej të cilëve në shkollë të mesme dhe tre në filllore. Edhe gruaja është e papunë.

E kisha një kredi që e kam marrë për me e rregulluar pak shtëpinë, e mu për këtë edhe i bëra kërkesë KEK-ut të ma vazhdoj kontratën, bile derisa ta barazoj kredinë. Më thanë se ligji nuk lejon.

E, pse mua ligji më detyroi të shkoj në pension kur pensioni nuk të siguron ekzistencë?

Do të detyrohen të gjashtë fëmijët e mi ta ndërprejnë shkollimin, sepse me 100 euro nuk do të kenë as bukë të hanë, e lëre më

të shkollohen, të vishen e të mbathen. Andaj, të gjitha rrugët, dyert e shpresat e familjes sime u mbyllën...

Ku, kah t'ia mbaj?

Si do të jetoj?

A jetohet kështu?

Pata rastin ta shoh një politikan në televizor, duke thënë: "Populli është i kënaqur".

A thua, për cilin popull e pat fjalën?

Ku jeton ai, ore?!

*

Në kafenenë "Pini", teksa kthej rrallëherë për një gotë verë, një mysafir para vetes kishte një kafe dhe dukej shumë i tretur në mendime.

Pas pak ofshani thellë dhe fill nxori fjalët:

"Ah, nënë bre!"

Ofshama dhe fjalët e tij bënë që shumica e mysafirëve ta kthenin kokën kah ai...

Kishte dhimbje, apo?

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Natyra Salihaj

Dizajni:

Labinot Bërbotovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com



Fëmijët e luftëtarëve të vërtetë s'kanë gjë pas shpirtit!

Kohë më parë Serbia e bëri një dokumentar për luftën në Koshare, për thyerjen e kufirit shqiptaro-shqiptar, kufi që konsiderohej si më i tmerrshmi në botë, ku faktori njeri i dha kahun e duhur fitores.

Për këtë luftë më kishte folur menjëherë pas mbarimit të luftës më 1999, një luftëtar që kishte luftuar atje. Më tregoi në detaje edhe për vrasjen e një hoxhe nga fshati Skifteraj i Vitisë, e që hoxha me bomba në dorë kishte hipur mbi një bunker ushtarësh serbë, duke i vrarë ata dhe duke e vrarë edhe veten. Ai aso kohe veç sa kishte filluar punën si imam i xhamisë në fshatin e tij...

SI E PA PROFETI MUHAMED NJË FËMIJË FUKARA?

Po e lidhi këtë storie të këtij tregimi me një storie fetare, e që bën pjesë në mrekullitë e profetit Muhamed.

Profeti i kishte parë për Bajram një tubë fëmijësh që luanin të lumtur. Por, në mesin e tyre sheh një fëmijë që ishte strukur e nuk luante me askënd.

"Po ti, pse nuk luan me fëmijë?", e pyet profeti.

"Mua më është vrarë babai në luftën e Bedrit, nëna është martuar, kurse burri i saj më ka përzënë nga shtëpia dhe nuk kam ngrënë as pirë, nuk kam as tesha për këtë ditë të shenjtë!", ia kthen fëmija.

"A pranon të vish me mua dhe të bëhesh djali im dhe i gruas sime Ajshes dhe vëlla i Ihsanit e Hysenit?", i thotë.

Djali i thotë po, me shumë kënaqësi. Profeti e mori dhe e veshi djalin mirë. Fëmijët e panë të lumtur dhe i thanë: "Çka ndodhi me ty? Deri para pak ditësh qaje, e tash dukesh më i lumtur se ne?!".

Djali i dëshmorit u tregoi se ç'kishte ndodhur, e fëmijët i thanë: "Qysh nuk janë vrarë edhe baballarët tanë, që ne të bëheshim djemtë e profetit!".

LUFTËTARËT E VËRTETË NUK U MBURRËN PËR TË BËMAT E TYRE

Pas lufte disa luftëtarë të Koshares kishin respekt shumë të madh në popull. Por, me kalimin e kohës, duke mos pasur, ata binin përditë e më shumë përtokë, aq sa nuk tregojnë as sa kanë vuajtur...

Pse?

Sepse, t'i thuash dikujt se jam filan komandanti, njerëzit ikin prej teje. Ikin duke menduar se ke të bësh me një dallaverexhi, fajdexhi...

Andaj, luftëtarët e vërtetë nuk u mburrën për të bëmat e tyre, por iu kthyen jetës për të siguruar kafshatën e gojës për familjet e tyre.

Dhe, në këtë aspekt mbetën të vobektë, e fëmijët e tyre duke i shikuar të tjerët se si jetojnë të lumtur...

Sokol Murturi



ZËDHËNËSJA MË E MIRË PREJ TË GJITHAVE

Valentina Bytyqi-Sefa, zëdhënëse e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), shumë herë nga mediet është raportuar si zëdhënësjja më e mirë prej të gjithave.

E, a është, vërtet, më e mira prej të gjitha zëdhënëseve të institucioneve kosovare, tregon fotoja e saj...



LUANDA KRASNIQI, SHITËSJA MË E BUKUR NË ZVICËR

Prindërit e Luanda Krasniqit janë nga Peja, por vite më parë janë shpërngulur në Zvicër. Andaj, atje është lindur Luanda, e që jeton në Cyrih të Zvicrës.

Me punën dhe përkushtimin e saj, ajo është fituese e disa çmimeve jo vetëm në Zvicër. Por, jo vetëm puna, ka qenë bukuria e saj që u ka rënë në sy shumë kompanive të njohura të modës. Ndërsa, revista me nam botëror e meshkujve "Maxim", vite më parë e radhiti atë në mesin e femrave më të bukura të shteteve gjermanisht-folëse.

Ka qenë mjaft aktive edhe në fushën e mode-limit, në shumë reklama, sfilata dhe manifestime të bukurisë.

Fakulteti nuk më shkoi, bile me kanë të martohem!

"Si e keni paramenduar veten pas kryerjes së shkollës së mesme?", është e vetmja pyetje që ua bëmë disa vajza që i hasëm në rrugët e Lipjanit, në këtë pranverë me borë...

ELZA, 19 VJEÇE:

- Vitin që shkoi e kam kryer shkollën e mesme, por për fat të keq dështova në testin e maturës dhe nuk arrita me kohë ta marrë diplomën, kështu që nuk arrita as të regjistrohem në fakultet.

Asnjëherë nuk më ka shkuar mendja se do të dështoj, të paktën, në testin e maturës, po ja që ndodhi, madje vetëm për një pikë!

Kam ëndërruar se menjëherë pas shkollimit të mesëm do të jem studente, por nuk ndodhi, nuk arrita të bëhem. Kam dashur të jem studente e gazetari-

isë, sepse shoqet dhe shokët se shkollës së mesme më thoshin se kam prirje për gazetari.

Megjithatë, po pres të vij qershori i sivjetmë dhe nëse mundem të regjistrohem në Degën e Gazetarisë të Universitetit të Prishtinës, sepse në universitete private nuk kam mundësi të paguaj.

VIRXHINIA, 20 VJEÇE:

- Që nga klasa X e shkollës së mesme kam menduar se si do të jetë e ardhmja ime pas mbarimit të shkollës së mesme, të jem studente a vajzë që rri në shtëpi, e që, ndoshta, shumë shpejt do të martohej. Dhe, pas mbarimit të shkollimit të mesëm, meqë nuk arrita të regjistrohem në fakultet, mbeta me pjesën e hidhur të ëndrrës sime.

Megjithatë, s'kam ç'të bëj, jeta vazhdon... Por, ishte shumë e dhimbshme kur ëndrra nuk të realizohet...

Andaj, s'më ka mbetur tjetër veç të martohem...

NERMINJA, 21 VJEÇE:

- Shkollën e mesme e kam kryer para dy vjetësh, por kushtet e vështira që i kemi

në familje nuk ma mundësuan t'ia mësyj universitetit.

Andaj, e tretur para televizorit, i paramendoj shoqet e mia studente, jeta e tyre në fakultet, në konvikte, në shoqëri me shoqe e shokë...

Sidoqoftë, prej katër shoqeve të mia, vetëm njëra arriti të regjistrohet në Fakultetin e Mjekësisë, e ne, të tjerat, mbetëm me "gishta n'gojë", siç thuhet në popull.

Por, edhe për mua lindi dielli, më në fund, meqë arrita të punësohem në njërin nga butikët më të njohur në qytetin tonë dhe më është kthyer buzëqeshje e venitur që moti...

VERANDA, 20 VJEÇE:

- Kam pasur dëshirë të regjistrohem shumë në Fakultetin Ekonomik, por nuk u pranova as parvjet e as vjet, kështu që u demoralizova dhe u thashë familjes të ma gjejnë një burrë.

U fejova me atë që ma propozuan familja gjatë gushtit të vitit të kaluar dhe tash jam në pritje të letrave të tij, meqë ai jeton në Londër.

E, a do të arrij të shkoj te ai, një Zot e di...

E. Ruhani



BREZOVICA
HOTEL & SPA



"Brezovica" Hotel & Spa është i vetmi hotel me pesë yje në Brezovicë. Mysafirët mund të zgjedhin nga 72 dhoma të mobiluara në një stil luksoz-modern, secila prej tyre ofron një pamje spektakulare mbi të gjithë perlinë e Brezovicës. Dhomat dhe suitat moderne me dizajnin dhe arkitekturën unike kombinon një përzierje elegancë, funksionaliteti dhe qëndrueshmërie.

REZERVO TANI!

+383 49 30 10 30

*Përjetoni të jashtëzakonshmen në
1100 metra lartësi mbidetare*

www.brezovicahotel.com

Suksesi krijon ura

Ndërmarrëset kosovare takohen me bizneset shqiptare në Gjermani, “Unioni i Bizneseve Shqiptare-Gjermane” nikoqir i shkëlqyer

Njëzet e një gra ndërmarrëse nga Kosova udhëtuan për në Dyseldorf ku patën mundësi që për dy ditë të takohen me dhjetëra biznese të udhëhequra nga shqiptarët në Gjermani. “Unioni I Bizneseve Shqiptare-Gjermane” si gjithmonë treguan se janë nikoqir të shkëlqyer, duke bërë një pritje dinjitoze dhe tejet informuese për të ftuarat.

i bizneseve shqiptare në Gjermani. Synimi jonë është që të dimë saktë se sa biznese ka gjithsej në Gjermani. Pika e dytë është që bashkë t'i përfaqësojmë këto biznese si para institucioneve lokale, qendrore deri tek federale”.

Sipas Abdullahut, pasi të bëhet identifikimi i të gjithë bizneseve të shqiptarëve në Gjermani më pas do të ideohet se si mund të kontribuohet në vendlindje pasi sipas tij “nuk gjen asnjë biznes që nuk e ka synim të jap kontribut në vendlindje”.

Pas këtyre fjalimeve u mbajtë paneli i diskutimit me temën “Mundësitë e bashkëpunimit: Diaspora për Gratë Ndërmarrëse” që u udhëheq nga Menaxherja e këtij projektit në GERMIN, Blerinë Ukshini. Panelistë ishin, Vesa Morina, Zeta Cooperation, Emire Duraku, Agro Krusha, Evelina Nreca-Ternava, Metaltech si dhe Fatmir Sinani, mentor nga diaspora. Pas panelit gratë realizuan takimet B2B ku patën mundësi të rrjetëzohen me bizneset nga diaspora. Më pas Anëtarja e Kryesisë së Unionit të Bizneseve Shqiptare dhe Gjermane, Shkëndije Berisha-Pacolli, ndau historinë e saj me gratë ndërmarrëse.

Vlen të përmendim se gjatë qëndrimit dhe takimeve të shumta, ato më pas patën edhe një vizitë tek biznesi i sektorit të ushqimit “Kelmendi GmbH”, ku u pritën nga i njohuri biznesmen, Vllaznim Kelmendi dhe bashkëpunuar tjerë të kësaj kompanie. Blerim Dreshaj pas prezantimit të Kompanisë i njoftoi të pranishmet edhe me disa nga procedurat, format e paketimit, kushtet e transportit he detaje tjera, që kërkohen në kuadër të legjisllacionit German dhe BE-së për produktet ushqimore. Ishte gjithashtu moment krenarie, kur disa nga pjesëmarrëset



Ato vizituan Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë (IHK) në cystatin e Essen, gjithashtu patën mundësi të takoheshin me biznese të udhëhequra nga shqiptarët në Gjermani. Bashkë-drejtoresha e GERMIN, Sihana Bejtullahu, tregoi detaje për projektin “Diaspora për Gratë Ndërmarrëse” që mbështetet nga USAID Kosovo Compete Activity. Ajo potencoi që kjo është kohorta e dytë e këtij projekti dhe tregoi sukseset e kohortës së parë kur një takim i ngjashëm u mbajtë në Cyrih të Zvicrës.

Bejtullahu, tha që duhet krijuar raporte më zyrtare mes diasporës dhe Kosovës.

Dafina Rexha, nga USAID Kosovo Compete Activity tregoi se si lindi ideja për të bërë një projekt që në fokus ka gratë ndërmarrëse në Kosovë. Rexha, shpalosi edhe sukseset e USAID Kosovo Compete Activity, duke potencuar që synimi kyç i këtij program është puna e afërt me sektorin privat me theks të veçante me sektorët e përpunimit të drurit, ushqimit dhe TIK-un. Drejtori Menaxhues i Unionit të Bizneseve Shqiptare-Gjermane në Gjermani, Fadil Abdullahu, foli përpara të ftuarve duke treguar qëllimet kryesore që ka ky union. “Objektivi i parë është identifikimi



shprehën falënderimet e tyre për bashkëpunimin që kishin filluar para disa viteve me Kompaninë “KELMENDI GmbH” dhe tanimë kishin rritur kapacitetet e tyre prodhuese në Kosovë dhe me të edhe angazhimin e gruas në Kompaninë e tyre. “KELMENDI GmbH”; sikurse edhe nga e kaluara do të vazhdojë t’u jap rëndësi plasimit të produkteve ushqimore në Gjermani dhe Europë me origjinë nga Vendlinja.



USAID, Compete Activity, GERMIN dhe Unioni i Bizneseve shqiptare-gjermane në Gjermani organizuan edhe tryezën e përbashkët në Dysdorf lidhur me temën “Gratë në Biznes”.



Pjesë e takimit, përpos këtyre organizatave ishin edhe 21 gratë ndërmarrëse nga Kosova, si dhe gra në biznes në Gjermani. Në këtë tryezë u diskutuan qëllimet, sukseset dhe sfidat e grave në biznes.

Të shtojmë se gjatë shkëmbimit të përvajave dhe njohurive biznesore, gratë nga Kosova prezantuan storiën e tyre të suksesit. Gjithashtu edhe gratë nga Diaspora, rrëfyn rrugët dhe sfidat e tyre deri në suksese dhe u zotuan se do të vazhdojnë të angazhohen që t’i motivojnë edhe grate tjera për kyçje në biznes.



Gratë ndërmarrëse kosovare për shtatë muaj ishin pjesë e projektit “Diaspora për Gratë Ndërmarrëse” që mbështetet nga USAID Kosovo

#CompeteActivity” dhe realizohet nga GERMIN. I tërë ky aktivitet u mbështetë edhe nga “Unioni I Bizneseve Shqiptare-Gjermane” në Gjermani.



Kush Ilogaritet VIP në Kosovë?

VIP (Very Important Person) apo "Person shumë i rëndësishëm" konsiderohet ai person i cili gëzon privilegje speciale, që statusin e tij e bëjnë të dallueshëm apo të rëndësishëm brenda shoqërisë.

Andaj, kush e gëzon këtë status në Kosovë dhe prej cilës fushë më shumë vijjnë ata?

Privilegjet e shumta, veturat luksoze dhe numri i madh i truprojave, janë vetëm disa prej elementeve që disa nga politikanët e Kosovës i bëjnë që të trajtohen si VIP-a, një epitete ky që kudo në botë u jepet personave, të cilët, brenda shoqërisë ku jetojnë e veprojnë, gëzojnë statusin e të privilegjuarve.

Ndërkaq, në Kosovë e kanë shumë më vështirë të trajtohen si figura të tilla njerëzit që vijjnë nga fushat e tjera, siç janë muzika, kultura, sporti..., të cilët, ndryshe nga politika, te ne sikur kanë mbetur në plan të dytë.

Por, një gjë dihet: Presidentja, kryeministri dhe kryetari i Parlamenti përcillen me eskortë nga policia e Kosovës.

Sidoqoftë, Kosova i ka VIP-at e saj. Andaj, cilët janë ata?



BIZNESMENI DHE POLITIKANI BEHGJET PACOLLI

Nëse dikë paratë e bëjnë VIP, ai, patjetër, është biznesmeni i njohur, Behgjet Pacolli, i cili që me formimin e AKR-së i hyri edhe politikës, madje arriti që me një përqindje shumë të vogël të votave që fitoi të marrë edhe postin e zëvendëskryeministrit, madje edhe postin ministër i Politikës së Jashtme, e pak kohë ishte edhe President i Kosovës.

Sidoqoftë, ai më shumë është jashtë Kosovës sesa në Kosovë, sepse jashtë e ka edhe biznesin e vet, i cili i sjellë përfitime të majme.

Sidoqoftë, në sytë e kosovarëve Begjet Pacollin më shumë e bëjnë VIP paratë e tij të majme sesa politika, e që deri tash nuk është treguar fare i suksesshëm.

POLITIKANI RAMUSH HARADINAJ

Ramush Haradinaj, kryetar i AAK-së, nga njerëzit përreth konsiderohet VIP i vërtetë. Lëvizjet e tij të shoqëruara nga një numër i konsideruar truprojash, veshja e shtrenjtë, martesja me një figurë publike – moderatoren e RTK-së, Anita Muçajn, si dhe dëshira e tij për të qenë i pranishëm kudo që arrin, e bëjnë Haradinaj njërin prej VIP-ave më kreativ në Kosovë. E, në kohën kur ishte në postin e Kryeministrit të Kosovës, epitete VIP veç sa i ishte shtuar.





SABRI FEJZULLAHU, KËNGËTAR

Nuk janë vetëm politikanët ata që brenda një shoqërie e gëzojnë statusin e VIP-it, me këtë as brenda shoqërisë kosovare, edhe pse te ne, pikërisht, privilegjet më të mëdha u janë akorduar politikanëve. E, nëse kemi një VIP në muzikën kosovare, ai i takon Sabri Fejzullahut.

Një kohë Sabriu provoi të merret edhe me politikë, duke qenë edhe deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së (dikur ishte adhures i flaktë i LDK-së së Ibrahim Rugovës), por nuk u tregua fare i suksesshëm në këtë drejtim.

Por, me gjithë suksesin që ka arritur me këngët e tij, Sabri Fejzullahu kurrë nuk është parë duke ecur me truproje e as nuk ka menaxher. Punët i kryen vetë, ndërkohë që mbetet i pazëvendësueshëm në skenë.



VETON SURROI – PUBLICISTI VIP

Deri para se xhamat e tij të jenë thyer me gurë, e që një gjë e tillë ndodhi që moti, njerëzit e kanë parë çdo ditë a mbrëmje publicistin Veton Surroi (dikur edhe kryetar i partisë "ORA"), duke shëtitur vetëm rrugëve të Prishtinës.

Por, kohët ndryshuan dhe një kohë të gjatë më Veton Surroi nuk ecte vetë.

Me vetë faktin se shumë herë ka deklaruar se pasuria e tij arrin në 40 milionë euro e më shumë, kjo e bën të konsiderohet VIP.



AGNESA VUTHAJ, MIS

E sprovuar në konkuret e bukurisë dhe duke qenë edhe "Miss Kosova", Agnesa Vuthaj është person i rëndësishëm në skenën kosovare edhe me rezistencën e saj për ta dorëzuar kurorën e bukurisë, pas pështjellimeve dhe premtimeve të rrejshme që asaj i ishin bërë nga organizatorët dhe sponsorët...

Megjithatë, Agnesa, që natyra veç bukurisë ia ka falur edhe mendjehollësinë, është person që merret me biznesin e vet, me të cilin qëndron shumë mirë. Agnesa, përndryshe, në jetën e përditshme është e thjeshtë, ndërsa bukuria ia ka mundësuar asaj të jetë në mesin e atyre që konsiderohen VIP-a të jetës artistike në Kosovë.

Diturie Haxhaj

Plagë lufte...

Kur dhe pse Petrit Morina jetoj 89 ditë në shpellë?



Petrit Morina

Fshati Çikatovë e Vjetër, i Drenasit, i ka katër dëshmorë kombi. Një krim mizor që kanë kryer forcat serbe, duke ua marrë jetën rreth 80 burrave e djemve të rinj dhe duke i zhvarrosur kufomat që t'ua humbin gjurmët në varrezat masive në Serbi.

Me të hyrë në fshatin Çikatovë e Vjetër, të komunës së Drenasit, edhe pse kanë kaluar 20 e sa vjet pas lufte, pllakat përkujtimore, mbishkrimet me përmbajtje pushkatimesh dhe flamujt kombëtarë dominojnë syrin e çdo vizitori, kalimtari a qytetari.

Me t'u lëshuar tatëpjetë Çikatovës nga ana veriore, përgjatë asfaltit të ngushtë rrugor mes dushkajës, një kullë guri pushton syrin, duke qëndruar si një ishull i vetëm në det.

Është kulla që u ngritë në shenjë të tre dëshmorëve: Fehmi e Xhevë Lladrovci dhe Fatime Hetemit. Aty Xhevë e Fehmi Lladrovci me Fatime Hetemin kishin rënë

në luftime, më 22 shtator 1998, vit kur edhe nisën luftimet në Drenicë. Çikatova e Vjetër, fshat që banorët tash e quajnë Shkabë, ka të vrarë rreth 80 banorë.

Tmerri më i rëndë u bë më 17 prill 1999, kur forcat ushtarako-paramilitare serbe u futën në fshat me tanke dhe armatim të rëndë, pasi granatuan fshatin nga pozicionet e "Feronikelit" dhe i grumbulluan meshkujt në disa grupe, duke i ndarë nga gratë dhe i pushkatuan në oborret e shtëpive.

Pak meshkuj mbetën gjallë nga ato grupe civilësh të vrarë, por ndër ta që mbijetoi është Petrit Morina, aso kohe 29 vjeç, e që aty humbi babanë dhe vëllanë.

Tmerri ishte aq i rëndë sa Petriti me disa të afërm u fshehën në minierën e gurëve në periferi të fshatit, duke qëndruar aty, madje, edhe një muaj pas hyrjes së NATO-s, kur u zbuluan nga disa fëmijë që ishin kthyer në shtëpitë e tyre me familje.

PETRIT MORINA MBIJETOI NËN TRUPAT E TË VRARËVE!

17 prilli 1999 ishte datë që ndryshoi jetën e fshatit dhe të banorëve të Çikatovës së Vjetër. Shtëpitë ishin djegur 80 për qind, ndërkohë që shumë burra e djem do të vriteshin më 17 prill 1999.

Njëri ndër ta, e që ishte në grupin e

djemve që u morën për t'u vrarë, ishte Petrit Morina. Djaloshi ishte në rresht me babanë, vëllanë e axhallarët e tij. Ai ende e kujton me tmerr ngjarjen e 17 prillit dhe ende nuk beson si ishte e mundur të mos ishte vrarë edhe vetë, në një rresht me të vrarët, ndaj të cilëve u shti me automatik në dy tri metra largësi.

Duke folur për ngjarjen tmerruese, ai thotë:

"Ishim të pasigurt të jetonim secili në shtëpinë e vet, andaj u tubuam në shtëpinë e babait të Jahirit. Ishim 3-4 familje me 18 vetë. Me ne ishte edhe Aliu, axha i babait, si dhe Kola, si i thoshim ne, Sokolit. Ishte ora gjashtë e mëngjesit kur fshati ishte rrethuar. Nuk kishim asnjë dalje për t'u larguar. Hyri ushtria e rregullt serbe në fshat dhe, pastaj, u futën edhe në shtëpi dhe komandanti ushtarak pyeti: "Kush është i zoti i shtëpisë?"

Dhe, ende pa marrë përgjigje, urdhëroi të dalim të gjithë nga shtëpia. Dolëm në rrugë, por hasëm në grupe të tjera ushtarakë, që ishin në të gjitha anët.

Na ndalën në rrugë grupi tjetër i forcave ushtarakë, që me vete kishin edhe paramilitarë. Në atë moment e kemi takuar Emin Morinën me familje dhe vëllanë, Selimin, të cilët kishin njerëz të huaj, e që u thoshim refugjatë. Ai ishte edhe me bijat e veta.

Neve na kanë rreshtuar me këto dy familje. Tre ushtarë i kanë urdhëruar gratë të ecin tutje, kurse ne të futemi në shtëpinë e

Besimit. Ishim nëntë vetë. Gratë qanin në rrugë, sepse e dinim se kur ndaheshin meshkujt, zakonisht i priste plumbi. Gratë e lotuara në atë moment janë kërcënuar dhe kanë ecur tutje, kurse neve kanë filluar të na pyesin kush jemi dhe nga jemi dhe a ka në mesin tonë ushtarë të UÇK-së.

Babai, Bahtiri, u përgjigj, meqë e dinte gjuhën serbe. U tha se ne jemi nga fshati, jemi të pafajshëm, jemi civilë...

Por, derisa ai fliste, komandanti i tha "mjaf", duke i bërtitur. Ata kishin qëllimin të na vrisnin dhe na urdhëruan të hynim në oborrin e Ylberit.

Dhe, ende pa i përfunduar mirë fjalët, dy rafalë automatiku janë zbratur në ne, që ishim në rresht e distanca ishte dy metra. Pesë vetë u vranë aty për aty. Më i vjetri ishte Kadriu, i cili deshi të ikte pasi mbeti gjallë, por i dhanë një breshëri plumbash dhe ai pas dhjetë metrash kishte mbetur i vranë pas një muri.

Në këtë dramë vrasjeje jam rrëzuar edhe unë. Pasi jam rrëzuar kam dëgjuar një "of" të babait tim, që ishte pranë meje.

Qysh kam mbetur gjallë nuk di... Më vonë e kam dëgjuar Sokolin kur e ka pyetur babanë tim (vëllanë e vet): "Bac, a je gjallë?". Ai u mundua të fliste, por nuk mundi.

Pastaj, dëgjova edhe një frymë të tij dhe vdiq.

Emini, e që kishte shpëtuar, i kishte tri plagë të rënda, Selmani - dy plagë, kurse unë, për çudi, s'e kisha asnjë plumb në trup.

Ashtu kam qëndruar deri kah mesdita. Ishte tmerr të gjendesh i gjallë në mesin e të vranëve... Binte shi dhe kishte vetëtimë e murmurimë. Kishte të shtëna dhe krisma nga forcat serbe në të gjitha anët... Kah mesdita vëreja se nuk lëvizte njeri. Sokoli nuk ishte aty. Jam tërhequr zvarrë, duke u strehuar pas një dere. Po aty e kam gjetur Eminin. U bëmë dy vetë pas odës së djegur. Emini më tha se i kishte tri plagë dhe mendohej ta shqyente këmishën që t'i lidhte, për ta ndaluar gjakun. I kam hequr tojat e këpucëve dhe ia kam ofruar. Ai i mori...

89 DITË NË SHPELLË!

"Në atë vend kemi qëndruar, pa u hetuar nga policia serbe, deri në mbrëmje. Atëherë jam ofruar te kufomat dhe e kam tërhequr babanë për ta ofruar më afër shtëpisë, që të mos qëndrojnë në rrugë. Dhe, duke mos pasur zgjidhje tjetër, kemi shkuar te miniera e gurëve dhe aty kemi qëndruar 89 ditë nën gurë, duke gjetur mbrojtje ndërmjet gurëve", Petriti pjesën tjetër të rrëfimit e përshkruan me detaje të mbijetesës... "Pas dy ditësh u takova me Sokolin dhe Selmanin. Edhe ata ishin ndaluar pak më

lart se ne, në gurëthyes.

Në njërin nga herët që isha natën nëpër shtëpia për të gjetur ushqim, në një shtëpi hasa në antibiotikë. I mora dhe ia dhashë Eminit, që t'i lehtësohej gjendja, sepse plagët nuk e linin të flinte, as të pushonte. Kishte dhimbje vazhdimisht dhe infeksioni i shtoej.

Një javë më vonë nuk kemi lëvizur askund. Kemi jetuar me atë pak bukë që gjetëm nëpër shtëpia, kurse pas një jave kemi tentuar të shkonim në Dobroshec, por na gjuajtën. Na hetuan edhe u detyruam të kthehemi.

Dhe, vendosëm: me apo pa bukë të qëndronim te gurët", shton Petriti.

EMINI VDES PA E PARË ASKUSH!

Duke kujtuar ngjarjet e asaj kohe, Petriti tregon detaje nga përkeqësimi i shëndetit të Eminit të plagosur, e që me kërkesën e tij u dërgua në ahurin e shtëpisë së tij, ku edhe kishte vdekur. Duke vazhduar rrëfimin, Petriti thotë:

"Emini, meqë ishte i plagosur rëndë, na tha ta dërgonim në ahurin e axhës së tij, sepse do të ishte më i mbrojtur nga kushtet klimatike. Emini na tha të mos rrezikonim më për jetën e tij...

Dhe, me kërkesën e tij e kemi quar në ahur.

Emini ka qenë në gjendje tepër të rëndë. Herën e fundit, kur shkuam ta shihnim a ishte ende gjallë, ishte data 16 maj. E thirrëm disa herë, por ai nuk u përgjigj. Ai kishte ndërruar jetë...

Më 30 maj dëgjohej një zhurmë e madhe... Serbët nga varrezat i kishin nxjerrë kufomat e pushkatuara dhe i kishin dërguar në Serbi, për t'i humbur gjurmët e vrasjeve.

Edhe një muaj pasi kishte hyrë NATO-ja, kemi jetuar ende te gurët e minierës. Nuk kemi ditur se çka po ndodh... Kemi qenë të izoluar nga bota. Pinim ujë në puse, por ujti i vinte erë shamponi! Nuk dinim se fëmijët e kthyer me familjet e veta vinin e lahashin në puse.

Më 13 korrik e ndezëm një zjarr që të piqnim bukë, nga mielli që ende na kishte mbetur... Fëmijët që kishin ardhur të lahen kishin vërejtur se nga gurët dilte tym.

Fëmijët, duke u ofruar, e kanë parë Selmanin (Sokolin) me mjekër të gjatë dhe kanë ikur nga ai. Sokoli u është lëshuar pas fëmijëve për të kuptuar si kanë mundur të vijnë aty.

Kur i ka zënë, ata i kanë thënë se ka ardhur liria, ka hyrë NATO-ja që një muaj dhe në fshat po kthehet popullata", përfundon rrëfimin Petriti.

S. Mururi

*Nga një kënd
ndryshe...*

A ËSHTË LODHUR BOTA ME NE?

Se bota është lodhur me ne, si ilustrim po e përdori një batutë:

Ishin zënë me fjalë dy shqiptarë në një barakë në Slloveni, e që kishin shkuar të punonin, për të siguruar kafshatën e gojës.

Me fjalë përleshin për emrin e një veture. Por, situata acarohet aq sa edhe përleshin ndërmjet veti dhe ndërhyjnë të tjerët t'i ndajnë...

Një shqiptar tjetër mundohet t'i pajtojë...

I thotë njërit:

"Fale bre burrë se kemi ardhur për bukë goje, e jo për luftë këtu! Po na bëni horë në mes të Sllovenisë!".

Por, edhe tjetrit ia thotë po të njëjtat fjalë.

E, kur sheh se nuk po mund t'i pajtojë, të dyve u thotë:

"More, copa u bëfshi! Kapni revolet e mbyteni njëri-tjetrin sa më shpejt!".

Andaj, do të lodhen një ditë edhe të huajt me ne dhe do na e bëjnë si pajtuesi në Slloveni...

Si i qoi Mevlydja në Hamam të Hyrës 6 burra?

*Fqinja ime e rinisë,
Mevlydja e Danit, pat
fat të keq me burra – u
martua gjashtë herë.
Por, në moshën më të
mirë të saj mbet pa
burrë, sepse burri i
gjashtë i vdiq teksa
punonte në një kanal, i
cili u shemb dhe dheu
e zuri të gjallë!*

5 VJET JETË ME BURRIN E PARË...

Me burrin e parë jetoi më shumë se pesë vjet dhe burri e lëshoi, sepse nuk u bënë me fëmijë.

I thashë: "Pse të lëshoi burri, moj? Pse ndodhi kjo gjë?"

Më tha: "Më lëshoi se nuk patëm fëmijë!"

U martua për së dyti dhe, thashë me vete, mirë që i punoi fati dhe e gjeti një burrë e shkreta! Por, as kjo martesë nuk i zgjati më shumë se një vit.

Përsëri e pyeta: "Pse, moj, po të ndodhin këto gjëra?!"

Më tha: "Lëre ti këtë muhabet, po shih

burrin tënd! Me të nuk kisha jetuar asnjë ditë!"

Ia ktheva: "Oj shoqja ime, pse i lë burrat?! Si ti nuk bën kush!"

Por, ajo heshti dhe nuk nxori zë nga goja...

PSE E LAKMONIN MEVLYDEN

BURRAT E MARTUAR?

Dhe, e gjeti edhe burrin e tretë, sepse, falë Zotit, ishte e bukur, e hijshme.

Shtatin e kishte të drejtë e të bukur.

Prapanicën e kishte të dalë pak jashtë, e i jepte pamje të bukur...

Edhe "dardhat" i kishte për merak, prandaj e lakmonin burrat, madje edhe të martuarit...

Por, kur u bën dy vjet u nda edhe me të, sepse ai kishte kërkuar që ajo t'i milte lopët, e ajo nuk donte t'i përlente duart me bajga...

E gjeti edhe burrin e katërt, me të cilin nuk jetoi as dy muaj dhe u nda. Dhe, meqë u nda aq shpejt, nuk kisha kohë ta pyesja pse, si, ku, qysh...

Dhe, u martua me të pestin! E, kur u martua me të pestin, të gjithë thanë se me të do të ketë jetë të mirë dhe të gjatë, me siguri...

Por, nuk ndodhi ashtu. Flitej se ishte

ndarë për arsye dembelie, nuk kishte qenë punëtor.

BURRI I GJASHTË – PA ASNJË MARIFET!

Burri i gjashtë që edhe burri i saj i fundit, sepse edhe filloi nga pak të plakej, e fuqia vinte ta lëshonte...

Ishte burrë nga një familje e ngratë, por shumë i urtë, i cili nuk ishte martuar asnjëherë.

Kur u martua me të thashë: "E paska pasur nafakë Mevlyden dhe do të rehatohet, më në fund!"

Por, ai nuk ishte për shoqen time, sepse kjo ishte shumë e bukur, ishte si mollë, me plot marmelatë në hijeshinë e saj...

E pyeta pse vendosi të martohet me këtë njeri të humbur: as i bukur, as i ri, pa asnjë marifet të mirë...

Më tha: "U martova me të që ta bëj, bile, një fëmijë, se unë po plakem e do mbetëm gjithmonë e vetme!". Por, as me të Zoti nuk i fali fëmijë, meqë ai, një ditë, duke punuar në një kanal, rrëshqet dhe dhe e zë të gjallë për fundi...

Dhe, tash e pesë vjet, Mevlydja e Danit jeton te vëllezërit në Fushë-Kosovë dhe u ndihmon kunatave në rritjen e fëmijëve...

L. Z.

BOOM

Bafte Shala

*zbulon personin
që fle dhe zgjohet
në qelizat e saj*

*Fenomeni
Luiz Ejlli*

*Pushimet
luksoze
të VIP-ave
shqiptarë
ende pa
ardhur vera*

Bafte Shala zbulon personin që fle dhe zgjohet në qelizat e saj



Vajza me emrin më unik, zeshkënia me shikimin shigjetë, këngëtarja atraktive dhe moderne, Bafte Shala, është përtej asaj që e njeh publiku. Bota e Bafte është e madhe, interesante dhe dinamike. Andaj, krejt çka nuk keni ditur për të, lexoni në “Boom”...

Bafte, fillimisht, çfarë kuptimi ka emri yt?

- Emri im Bafte i takon fesë myslimane, e edhe unë i përkas kësaj feje. Emri ka kuptimin "Fat nga Zoti". Dhe, vërtet, kam fat, për çka e falënderoj Zotin.

Ç'thonë njerëzit kur e dëgjojnë emrin tënd?

- Në fillim u duket i padëgjuar dhe më pyesin a mos është emër i huaj. Pasi ua shpjegoj se emri im është i trashëguar nga gjyshja, thonë se, vërtet, u duket emër modern.

Publiku të njeh si këngëtare e bukuroshe. Megjithatë, kush është Bafte Shala me pak fjalë?

- Jam nga komuna e Gjakovës, e rritur në një familje ku dashuria dhe edukata kanë qenë në rend të parë. Qysh si e vogël kam qenë ambicioze dhe kam pasur synime të bëhem dikush që njerëzit ta përmendin për të mirë, t'i arrij qëllimet dhe ëndrrat e mija, të cilat edhe po i realizoj me punë. Jam vajzë e qetë, por me shpirt luftarak dhe e vendosur për atë që synoj ta kem. Jam e rrethuar me njerëz pozitivë. Pika ime e dobët ka qenë shkollimi.

Cili është shkollimi juaj?

- Kam diplomuar në Universitetin e Prishtinës, në Degën Fizioterapi. Po ashtu, kam diplomuar edhe në një kolegji privat për "Shkenca politike".

Si e përshkruan veten, e si të përshkruajnë të tjerët ty?

- Punëtore, e dashur, kokëfortë, e vendosur për gjërat që i kam prioritet. Njerëzit kanë mendime të ndryshme, por gjëja e përbashkët që më kanë thënë është se punoj shumë dhe kur janë me mua ndjejnë qetësi dhe komoditet. Pa dyshim, njerëzit thonë: "A do të lindë ndonjëherë një Bafte e dytë?"

Pse zgjedhe të merreshe me muzikë?

- Ka qenë zgjidhja më e mirë që kam bërë në jetë. E ndoqa ëndrrën dhe i mbusha shumë mangësi që m'i servoi jeta.

Kënga që të afroji më së shumti me publikun?

- Kënga që më ofroi më së shumti me publikun është kënga "Hala t'du", sepse shumë njerëz e gjejnë veten në të. Është një baladë moderne, ku një herë vuan, pastaj fillon e kërcen...

Një sekret për të depërtuar në botën e muzikës?

- Të jesh e dashur me publikun dhe të ofrosh energji që ata t'i bëjnë të ndjehen mirë, meqë shumica e njerëzve që dëgjojnë muzikë kanë më shumë adrenalinë. Pra, duhet ta bësh këtë punë me zemër dhe ta shfaqësh tek njerëzit më të mirën...

Personi i parë që të duartroket?

- Dashuria më e madhe, forca ime, energjia, ai që fle e zgjohet në qelizat e mija. Është krahu im i djathtë, shembulli im i punës, sjelljes e i suksesit.

Ai që ma mbajti dorën të mos rrëzohem asnjëherë, e më duartrokiti pas çdo pune të kryer, duke përfshirë edhe fillimet e mija.

Njeriu që i gëzohet çdo sukcesi që kam... E, pa të nuk do të isha kjo që jam...

Ke marrë ndonjë mesazh urimi nga Tayna, apo marrëdhënia është "e ngrirë"?

- Jo, nuk kam marrë, por edhe nuk kam kërkuar ndihmë nga Tayna dhe askush i estradës, sepse çdo gjë kam dashur ta arrij me forcat e mija dhe të sfidohem nga gjërat që nuk i di, me qëllim që të bëhem më e zonja në këtë punë. Sidoqoftë, ia uroj më të mirën dhe të jetë e suksesshme si deri më tani në botën e rep-muzikës.

Ke edhe bashkëpunime. A do të ketë edhe më tej duete?

- Duetet janë specialitet imi, sepse miksohen dy zëra të ndryshëm dhe bëjnë që publiku t'i shkrijë emocionet në të. Njëherë jo, por do të ketë...

Një projekt të ri e ke gati. Konkretisht?

- Veç sa i kam përfunduar xhirimet e klipit të këngës më të re. Është një shkrimje e një kënge të vjetër të kthyer në moderne, punuar me shumë mjeshtri nga producenti i njohur Berato. Mezi po pres ta lansoj...

Ndërkohë, po flitet se së shpejti do prezantohesh edhe si dizenjatore e modës. A është e vërtetë?

- Moda është ajo që më shoqëron kudo, që më çliron nga lodhja e ditës, sepse aty koncentrimi im është qind për qind dhe vënia në pah e më të mirës. Veshja te një person tregon të bukurën, elegancën, qëndrimin dhe atë se si ndihet ai brenda. Shumë shpejt ju pres në studion time të re të dizajnit të rrobave, madje do punoj diçka për ju...

Moda apo muzika do të kenë përparësi në jetën tënde?

- Muzika është primare për mua, por edhe pa modë nuk mundem, sepse dëshira për t'u dukur bukur më shoqëron gjithmonë. Gjithsesi, muzika është ëndrra, pasioni dhe dashuria më e madhe.

Çka nuk ke thënë dhe a ka ardhur koha për të treguar?

- Që jam në një menaxhment të ri muzike, çka nuk e kisha deri më sot, pasi doja ta masja veten. Por, tash përgjegjësia dhe puna është më e madhe... Kam publikun tim. Kam përreth njerëz të kësaj fushe, me qëllim që të ofroj më të bukurën për ta.

Planet?

- Jam duke punuar në këngë të reja, meqë vera po vjen. Po ashtu, do të jem në shumë vende për t'i performuar këngët e mija.

Të qoftë vera me fat...

- Faleminderit!

Nderim Neziri



Pushimet luksoze të VIP-ave tanë ende pa ardhur vera

Pushimet janë ditët e të bukura që çdo njeri dëshiron t'i kalojë pranë personave më të dashur. Pushimet janë një "infuzion" edhe për VIP-at tanë, për të marrë energji për një sezon të ngarkuar veror që po vjen. Zanzibari dhe Bali ishin destinacioni i preferuar i të njohurve tanë gjatë fillimit të kësaj pranvere. Pranë detit dhe natyrës disa nga VIP-at tanë kaluan ditë të paharrueshme...



BESI, XHENSILA DHE AJKA GJETËN KËNAQËSI NË BALI

Ata kaluan disa ditë në Bali, ku kohë pas kohe ndanë momente të bukura me ndjekësit e tyre. Xhensila nuk hezitoi të shfaqë edhe super linjat trupore. Familja e tyre ishte shumë e lumtur dhe më e bashkuar se kurrë.

LEDRI, SARA DHE POEM BLU NË PUSHIME PËRRALLORE

Çifti pushimin e kaluan në Bali dhe kjo nuk ishte hera e parë që ata e vizituan këtë vend. Me ta ishin edhe disa miq dhe bashkë kaluan ditë të bukura pushimi.



ENCA PROVOKUESE DHE ENIGMATIKE

Enca udhëtimet në vendet tropikale i ka shpeshuar. Edhe pse asnjëherë nuk tregon se kush po e shoqëron, Enca poston fotografi shumë provokuese.

EFI U SHKRI NË TAJLANDË!

Pas daljes nga "Big Brother VIP Albania", Efi i kushtoi kohë vetes për të shijuar detin dhe natyrën. Ajo zgjodhi Tailandën dhe Filipinet për t'u relaksuar. Thuhet se ishte me të dashurin...



ERA ISTREFI: "QATY KU S'JE TI"!

Era është mjaft e rezervuar sa i përket jetës private. Ajo edhe pse ndau fotografi pranë detit, nuk tregoi se ku është, por la vetëm mbishkrimin: "Qaty ku s'je ti".

YLLKA KUQI FESTOI DITËLINDJEN E BASHKËSHORTIT NË VEND PERFEKT

Yllka pushimet e fundit i realizoi jo pa arsye, festoi ditëlindjen e bashkëshortit pranë detit bashkë me vajzën e tyre të vogël.



ARIANA FEJZULLAHU NË PUSHIM PA ERMALIN

Kontinenti i Azisë ishte destinacioni i Arianës. Ajo nuk na tregoi se kush e shoqëroi në pushime, por një gjë dihet, Ermali nuk ishte me të.

Edona Vllasaliu-Bajoku



Fenomeni Luiz Ejlli

Luiz Ejlli u rikthye totalisht në qendër të vëmendjes përmes “Big Brother VIP Albania”.

Loja e Luizit në atë format televiziv nuk ishte aspak lineare, meqë gjatë 133 ditëve të qëndrimit në “Big Brother VIP” krijoi situata nga më të ndryshmet, duke u nisur nga debatet e forta, tensionet e trazirat, por edhe historia e dashurisë.

I BËRI TË GJITHA DHE FITOI...

Fenomeni i atij edicioni, Luiz Ejlli, në natën finale është martuar me prezantuesen Kiara Tito dhe martesë e tyre është celebruar nga kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj.

Ndërkohë, Luizi e ka arritur edhe aspiratën më të madhe, triumfin dhe marrjen e shumë 100 mijë euro.



VLORË, ALBANIA



Maritim Marina Bay

The best place – to be!



Hey there, summer lovers! Are you ready for the hottest season of the year? The moment has arrived for us to embrace the new season, and trust me, it's going to be epic! With the sun shining bright, the waves crashing, and the sand between our toes, we can't help but feel alive. Summer is all about having fun, and what better way to do it than by partying and enjoying the best nightlife around?

To reserve call +355696041000 | www.marinabay.al

MAY

Pse i mbajti Nazmi Berisha nga Podujeva, 20 vjet burg në Shqipëri?



Më 8 nëntor 2022 ndërroi jetë në Sarpsborg të Norvegjisë, në moshën 84-vjeçare, Nazmi Mehmet Berisha, një prej shqiptarëve të Kosovës, i cili vuajti 15 vjet burg në regjimin komunist në Shqipëri. Atje jetoi pa grua, pa fëmijë, pa shtëpi, pa pozitë shoqërore, pa stabilitet emocional, pa intimitet të theksuar, pa pasuri, pa afirmimet personal, pa shumëçka që jetën e bën jetë!

Nazmi Berisha, nga Podujeva, në vitin 1960 u arratis në Shqipëri, për të shpëtuar nga persekutimi serb dhe gjeti në Shqipëri një persekutim më të keq të një regjimi antikombëtar, i cili i kishte shqiptarët e Kosovës pjesë të armiqve të tij. Nazmi u dënua dy herë, duke vuajtur dënime në vitet 1962-1972 dhe 1975-1980. Herën e dytë u orvat të arratisesh, por

u arrestua.

Gjatë qëndrimit në Shqipëri, në burg dhe jashtë tij, nuk jetoi asnjë ditë lirie. Vuajti dënimet në Burrel, Rubik dhe Ballsh. Nazmi ka lënë një vepër të shkruar, "20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës", botuar në Berat, 1995, libër me shumë informacione dhe që tregon dramën e vërtetë të shqiptarëve të Kosovës që bënë gabimin e jetës dhe erdhën në një regjim antikombëtar, si ai që ishte vendosur në Shqipëri. Nazmi u lind në vitin 1939, në Llap. Si shumë të rinj të tjerë kosovarë, e që asokohe nuk e duronin dot shtypjen e regjimit titist me metodat rankoviqiane, edhe Nazmi Berisha, në moshën 21 vjeç, i joshur edhe nga propaganda e regjimit komunist shqiptar për "begatinë socialiste", vendosi të arratisesh nga Jugosllavia për në Shqipëri. Në librin e tij, Nazmi thekson: "Teksa rritesha, në stacionin e trenit të Prishtinës me qindra kosovarë, me brengën në zemër, linin atdheun për të shkuar në Turqi. E, ajo ishte një lamtumirë rrëqethëse. Në radion me bateri, që e kishte blerë babai, përcillnim në Radio-Tiranë çdo vit paradën e 1 Majit. O zot, ç'krenari! Madje, dëgjova të fliste Enver Hoxha, legjenda e Shqipërisë. Dhe, ai zë ma mbushi zëmren plot..."

SI E KALOI NOT LUMIN "BUNA"?

"Vendosa të ikja. Më në fund, i hipa autobusit për në drejtim të Ulqinit. Isha i lodhur e i dërmuar, mirëpo më mbante gjallë shpresa se së shpejti do të isha në Shqipëri.

Dhe, natën iu hodha Bunës me not. Mendimi i parë që më lindi në tokën e ëndër-

ruar, ishte që t'i dorëzohesha policisë, mirëpo nuk hasja në njeri.

Por, duke ecur, pashë ca bagëti dhe një dritë të ndezur. Thirrjes sime: "O shqiptarë", iu përgjigjën disa kërcitje armësh dhe thirrja: "Duart lart!".

Dy ushtarë dolën nga errësira dhe m'i lidhën duart mbrapa me rrip. Në postën e policisë u përballa me një oficer që rrinte në karrige. Sjelljet e tyre brutale i justifikoj, sepse vija nga matanë kufirit, ku dy shtetet ishin armike ndërmjet veti.

"Dua të shkollohem këtu dhe të bëhem i vlefshëm për Shqipërinë!", i thashë. Më pas dy ushtarë më thanë se do të më çonin në Shkodër, për të cilën qytet kisha dëgjuar shumë histori.

Më futën në një dhomë ku ishte një fotografi e madhe e Enver Hoxhës, për të cilën kisha afekcion. Unë u emocionova shumë dhe oficeri, që e vuri re këtë gjë, më lejoi të ulesha.

Mundohesha ta largoja frikën, duke menduar se këta oficerë nuk ishin si ata të UDB-së, që e kishin rrahur axhën tim...


Më pas më futën në qeli burgu. Aty më kaploi gjymti dhe vetëm të nesërmen u zgjova.

Ditën e dytë më nisën për në Shijak, e Shkodrën e ëndërruar nuk e pashë fare. Në Shijak më vendosën në një shtëpi, që e quanin Shtëpia e Pritjes. Edhe aty filluan pyetjet e policisë, si ato në Shkodër...". Nazmi Berisha i vuajti 20 vjet në burgjet e regjimit komunist, i akuzuar si agjent i UDB-së.

U lirua më 3 qershor 1980 dhe kërkoi që të riatdhesohej në vendlindjen e tij, në Kosovë. E, ajo gjë iu plotësua.

E sollën në pikën kufitare të Morinit dhe e lanë të lirë.

Olive



Kirurgjia e Obezitetit Ngushtimi i lukthit

+383 44 600 303 Magj. Prishtinë - Ferizaj Kilometri i 9-të

S'ka më mirë se me e pas burrin budallë!

Bëmë marrëdhënien e parë seksuale pas dy muajsh që u njohëm, por ai (tash burri im) as që e mori vesh se jam e prekur a jo, sepse shtiresha kishe ndjeja dhembje...

Jam grua e martuar dhe, për të mos e zgjatur shumë, po dal në temën ku po më dhemb...

Babanë na e vranë në luftë, e nëna u bë edhe nënë, por edhe babë për ne, 4 fëmijët që aso kohe ishim shumë të vegjël.

SI U BË NËNA ME DASHNOR?

Ndërkohë, meqë jetonin në kushte tejet të vështira, nëna ishte detyruar të sigurojë ekzistencën tonë dhe ishte njohur me një mashkull shumë më të vjetër se vet dhe na njoftoi me të.

Tha: "Ky ka me na ndihmuar të mbesim gjallë!"

Por, mua ai s'më pëlqeu fare, sepse, edhe pse isha vetëm gjashtë vjeçe, mendja nuk më largohej kurrë nga babai.

Dhe, me kohë ata u bënë dashnorë, e kjo gjë më pengonte shumë...

Por, nëna, me shkathtësinë që kishte, nisi të merrej me biznese të vogla, që të lirohej nga dashnori i saj, që na mbante materialisht dhe puna nisi t'i shkonte mirë, ku na angazhonte edhe neve, fëmijëve.

NDODHI E KEQJA: MBETA SHTATZËNË PARA SE TË MARTOHESHA!

Kur i mbusha 18 vjet u martova me burrin që e kam tash.

Sidoqoftë, para se me u martuar nuk pata të dashur. I pata do lodhje "ad hoc", siç thuhet dhe me njërin mbeta shtatzënë, por abortova dhe ajo gjë nuk u hetua në familjen time.

E, ajo shtatzëni e padëshiruar bëri që unë të mbushesha mend dhe u largova nga aventurat e shumta.

Por, njohja me njeriun, të cilin tash e

kam burrë, e ndryshoi plotësisht jetën time.

Dhe, erdhi koha me u fejuar. Por, i fejuari im, tash burri jem, s'mori vesh a isha "e prekur" a jo, sepse shtiresha kishe ndjeja dhembje...

E, kjo për mua ishte mrekulli dhe u gëzova që nuk mori vesh asgjë.

Andaj, kjo më gëzoi pa masë...

Por, edhe pse e martuar qe katër vjet, nuk po mund të mbes shtatzënë! Si duket, aborti që pata ka qenë fatal për mua...

L., Ferizaj

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play

remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja
Frankfurt, Këln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.

Na kontaktoni në info@remos-restaurants.de



[remos_restaurants](https://www.instagram.com/remos_restaurants)

| info@remos-restaurants.de

| www.remos-restaurants.de

Familja më shkroi hajmali se e mora vejushën me 3 fëmijë!

Familja më shkroi te hoxha i lagjes sonë se e kam marrë gruan me 3 fëmijë. Baba më shumë po rri në spital se në shtëpi...

Para një muaji i mbusha 35 vjet. Por, nga veprimi që kam bërë jam si në kohën e adoleshencës. Shkurt e shqip: dikur isha në lidhje me një femër më të vjetër se unë, por ajo, meqë unë nuk punoja asgjë, u martua me një të pasur të lagjes sonë dhe unë mbeta me gishta n'gojë!

SI U NJOHA ME GRUAN VEJUSHË ME 3 FËMIJË?

Para një viti, duke hulumtuar në "Instagram", hasa në një femër, e cila pa përtesë filloi të komunikojë me mua. Më tregoi për jetën e vet të vështirë

që kishte pas vdekjes së burrit, me të cilin kishte 3 fëmijë të vegjël. Dhe, i premtova se do t'i dilja në ndihmë sa herë që të kishte nevojë. Por, me kalimin e kohës, nisa të dashurohesha në të dhe dita që kalonte pa komunikim me të më ishte shumë monotone...

Prindit e mi nuk dinin gjë për lidhjen time shpirtërore me vejushën, nënën e tre fëmijëve të vegjël. Por, një ditë vendosa t'i tregoj babait se isha i gatshëm të martohesha, meqë isha dashuruar shumë në të. Dhe, nga ai debat shumë i rëndë me babanë, vendosa të dilja nga shtëpia dhe të jetoja vetëm, me qëllim që herët a vonë të martohesha me nënën e tre fëmijëve...

Mirëpo, po ato ditë u sëmure babai dhe e dërguan në spital, e ai rast bëri që unë të kthehesha në familje. Sidoqoftë, jam tip që kur dashuroj një femër nuk kam sy për të tjera.

Andaj, edhe pse nuk jetoja bashkë me vejushën, e doja me gjithë shpirt dhe i besoja shumë.

Po ashtu, edhe ajo më donte shumë dhe thoshte se nuk shikon njeri tjetër veç meje. E, kjo më shtynte që ta doja edhe më shumë...

SI E KRIJOVA RRËMUJËN NË SHTËPI?

Dhe, meqë koka më vlonte nga dashnia, vendosa të martohesha me të, u pajtuan a s'u pajtuan, deshën a s'deshën prindërit e mi...

Por, kur e solla në shtëpi me 3 fëmijët e saj, krisi belaja: baba u sëmure sërish dhe u shtri në spital. Nëna shkoi te hoxha i lagjes sonë dhe më bëri hajmali të madhe.

Kështu, në vend se të krijoja harmoni në familje, shkaktova një rrëmujë dhe po ajo rrëmujë po vazhdon edhe tash. E, sa do të zgjasë kështu një Zot e di...

Virusi, Prizren



allure[®]
B E A U T Y

PËR HERË TË PARË NË SHQIPËRI LIFTING PA KIRURGJI



EJA ZBULO SEKRETIN E
fiber lift

Adresa: Rruga "Rreshit Collaku", Tirane

Insta: @allurebeauty

Tel: +355692111919

Jeta ime: 10 vjet vejushë!

“Në qoftë se ekziston femër në botë të ketë vuajtur shpirtërisht si unë, atëherë ajo do të ketë përfunduar në humnerë të pafund”, thotë Ermira, 40 vjeçe, nga Rahoveci.

“Ishte hera e parë që në vitin e fundit të shkollës së mesme po më rroknin do farë dridhjesh të çuditshme, e që nuk më kishin goditur asnjëherë tjetër. I thosha vetes se isha ende tepër e re, për të mos thënë fare e pamësuar dhe tej mase e frikësuar të nisja dashuriçkat e moshës që i takoja, edhe pse shoqet e mia nuk e qanin kokën për gjëra të tilla.

SI NISA TË DALË NGA “UDHA E ZOTIT”?

Por, që në këtë kohë fillova të dal pak nga “udha e Zotit” dhe këtë devijim timin lozonjar e vërejtën menjëherë vëllezërit e mi, të cilët më ndaluan të dilja nga shtëpia pa i pyetur paraprakisht se kah do ta thyeja qafen.

Për këtë arsye edhe humba besimin e tyre për të vazhduar shkollimin më tutje, pra studimet në Prishtinë, e që ishte një goditje e rëndë për mua dhe e para në jetën time.

Dhe, deri në moshën 21 vjeçe jeta ime ishte e njëjtë: e zymtë dhe krejtësisht monotone, edhe pse kohëve të fundit ki-

sha dal nga pak nga shtëpia, por nuk kisha njohur askënd.

Nëna shpesh ma përmendte martesën, por nuk e dinte se ku do më jepnin vëllezërit. Pas një kohe, njëra nga motrat e martuara më propozoi fejesë me një djalë që bashkëshorti i saj e kishte të afërm.

Dola me të, por nuk më pëlqeu. Po atë verë, për çudi, pa menduar gjatë, u fejova me një shok të vëllait tim, i cili ishte djalë me fakultet të kryer dhe pasuri të madhe në një fshat të komunës së Suharekës, të cilit nuk dua t’ia përmend emrin, sepse tash më neverit.

Për çudi, më pëlqeu që në takimin e parë. I tregova se nuk kam pasur lidhje me askënd, kështu që ai të flinte rehat. Dasma u bë një të diel me shi, erë dhe bubullimë.

MË THANË: NUSE SHKO MILI LOPËT!

Dhe, pika e vlimit tim ndodhi pas dy javësh, kur më thanë të shkoja në ahur dhe t’i milja lopët. Kundërshtova para të gjithëve dhe në atë moment burri më ra

shuplakë. Më pas grushtimet e tij pasuan edhe në dhomën e fjetjes.

Dhe, që nga ajo ditë, edhe pse bëra jetë me të një vit, mezi prisja të gjeja rastin që t’i jepnim fund martesës dhe të mos rrija asnjë ditë në atë shtëpi.

Ç’JETË BËJ SI VEJUSHË?

Por, jeta si vejushë ishte edhe më e rëndë se ajo kur rrija e mbyllur para martese në shtëpi. Tashmë nuk më pengonte askush të dilja, por sa herë që dilja në rrugë më bëhej se të tjerët flisnin vetëm për mua...

Dhe, sa herë që dilja në qytetin tonë, veç sa dëshpërohesha, sepse shumëkush mendohej të më shtinte në dorë, qoftë edhe për një natë.

Andaj, edhe pse kanë kaluar 10 vjet, më nuk kam besim në askënd dhe si vejushë më shumë rri mbyllur sesa që dal nga shtëpia, sepse e kam emrin e keq: Vejushë!”, thotë Ermira, në rrëfimin e saj rrëqethës, atë ditë që e vizitova në shtëpinë e saj në Rahovec.

Diturie Haxhaj

PRIMETRAVEL
Smile



SKANO, BONU PRIME



Ti e meriton
një pushim **PRIME!**



A duhet të martohen vejanët a të jetojnë në vetmi?



“S’ka më keq se të jesh mysafir në shtëpinë tënde!”, kështu thonë disa nga bashkëbiseduesit tanë nga Prizreni dhe rrethina e tij...

SHEMSIU:

MJERË AI BURRË QË ËSHTË PA GRUA!

“Sapo i pata mbushur 60 vjet më pat vdekur gruaja”, thotë Shemsiu, nga Lagjja “Arbana” e Prizrenit, tash 71 vjeç, burrë i cili qe 11 vjet jeton pa grua.

“Pas një kohe që më vdiq gruaja mendova të martohem. Doja të gjeja edhe një herë fatin e jetës sime, por pasi u mendova gjatë e gjatë, me vete thashë: “Më mirë të rri kështu si jam, sesa t’ua prish jetën fëmijëve të mi!”.

Por, më vonë u pendova, sepse sa më shumë që kalonin vitet aq më mysafir e ndjeja veten në shtëpinë time!

Andaj, mjerë ai burrë që mbetët pa grua!”, thotë Shemsiu.

MEHMETI:

REJAT KUJDESEN PËR MUA, POR...

“Kam qenë 56 vjeç kur më vdiq gruaja. Kam kaluar mirë me të, por, e shkreta, u sëmur dhe vdiq. Kurrë nuk e pata tradhtuar...

Pas vdekjes së saj nuk dija si ta drejtoja jetën! U gjenda në udhëkryq: Të martohem-

sha a të vazhdoja jetën vejan?

Dhe, vendosa të martohem. Por, nuk më lanë djemtë: “Ose me ne ose me gruan që do e marrësh?!”, më thanë.

U solla e u pështolla dhe vendosa: më mirë të jem me fëmijë se me gruan që nuk do ma donin...

Keq a mirë, kështu vendosa...”, thotë Mehmeti, i cili para pak ditësh i kishte mbush 69 vjet.

ZENELI, NGA KORISHA:

VEJANI - SI QENI ENDACAK!

“Vejan a qen endacak, është njëjtë, sepse kujt t’i teket të qorton! Unë, pas vdekjes së gruas sime, nuk desha të martohem, jo se nuk pata mundësi, por frikësohesha se çfarë grua të ardhshme do merrja!”, thotë Zeneli, 71 vjeç, nga Korisha e Prizrenit, i cili qe dhjetë vjet jeton pa grua.

MASARI, NGA ZHURI:

MË ÇLIROI ZOTI PREJ GRUAS SË DYTË!

“I kam katër djem me gruan e parë. Por, ajo vdiq në moshë të re, kur ishte 41 vjeçe.

Kishte qenë jetëshkurtër. E kam dashur shumë, por fati ishte i tillë që të mos jemi bashkë gjithë jetën.

U martova me të dytën, por asnjë çast lumturie nuk pata me të, sepse nuk m’i donte fëmijët!

Kur u rritën fëmija dhe u bën të zotët e vetvetes, më braktisën edhe mua e edhe atë... Por, deshi Zoti dhe para dy vjetësh më braktisi dhe më çliroi Zoti prej saj...

Tash jetoj vetëm, në vetmi...

Djali më i vogël dëshiron të shkoj të jetoj me të, por unë nuk dua, sepse e kam lënduar shumë kur qesh martuar për së dyti... Andaj, dua ta marrë dënimin e merituar!”, thotë Masari, 61 vjeç.

ÇKA MUND TË PËRFUNDOJMË?

“Ndoshta është vështirë të jtohet në vetmi, por për hir të fëmijëve, familjes, është mirë të mos i përziësh fëmijët, sepse pasojat shihen tek më vonë!”, kështu tha një bashkëbisedues nga Zhuri.

Orhan Biberi

KEY TO YOUR Dream House



Lagjja Panorama - Ferizaj



Kur shkove nuse, fshehur pas blirit të shikova ty!

*Nuk di a je e lumtur,
duke e fshehur në
brendinë tënde dikë
që i thua “shpirti i
shpirtit tim”?!
PËR TY...*

Ti, që je hyjnore, e di më së miri se këto
fjalë janë për princeshën...
Sot ke ikur në heshtje. Nga sytë e mi rrod-
hën pika loti për ikjen tënde. Por, edhe ti
do qash për martesën tënde pa dëshirë.
Sivjet as lulet nuk do qelin, as fluturat nuk
do fluturojnë...
Sot ike heshtazi. Do të qeshësh para
dikujt, duke e fshehur dikë tjetër në
zemër. Ëndrra më kishte kapluar nën
mundimin e kësaj dashurie të hidhur,

kur sot do të shkoje ti, në shtëpinë
tënde të re.

KUDO DO MË KESH PARA VETES!

“Ditën e mirë, flutura ime! Kur të dalësh
nga dera e shtëpisë sate, do më kesh para
vetes. Mos harro ta ngritësh kokën. Më ke
premtuar se do më shikosh aty ku do jem
unë, te bliri i rrugës tënde.
Sidoqoftë, do të ketë shumë njerëz, do të
ketë shumë dasmorë që do të përqafohen
për ty, në ditën tënde më të lumtur.
A ka ndryshuar diçka në këtë ditë apo më
ke harruar?!
Heshtja flet më së miri, por ne nuk e kemi
varrosur dashurinë tonë.
A do të duket e bukur nata dhe a do të
jetë nata jote më e lumtur?
Para meje rri një gotë verë, te kafeneja e

dikurshme, te parku i qytetit.

E cakëroj gotën me verë me gotën e ujit,
për zemrën time të plasur...

Dhe, seç më kujtohen vargjet e këngës së
njohur, që i këndoje ti:

“Atë ditë kur të bëhesh nuse

Dil n’dritare me të pa

Sytë e zezë faqet e kuqe

I mjeri unë plasa tu qa”.

Andaj, atë ditë kur të bëhesh nuse, hidh shi-
kimin kah unë dhe shih se sa shumë të dua!

Është kohë ndjenjash të hidhura.

Nuk më jetohe tutje, kështu, vetëm...

Gëzuar!

Pas një kohe ngrihem dhe shoh se më
kanë kapluar djersët në trup. Të gjitha
për ty, sepse jetojmë duke u dashur dhe
qeshmi para të tjerëve duke e fshehur
njëri-tjetrin në thellësi të zemrës, o shpirti
i shpirtit tim...

S.



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

A do të heqë dorë burri prej meje?

Zonja magjistare, ju përshëndes nga zemra! Jam 34- vjeçare, jetoj jashtë Kosovës, kam një fëmijë. Burri nuk jeton me mua, por në Kosovë. Ka kohë që ai më paralajmëron për ndarjen tonë. A do të ndahemi?

Përgjigje:

Bashkëshortësia ka kuptim kur çifti jeton bashkë dhe ndan problemet e përditshme së bashku. Ju keni fëmijë, por ai nuk jeton me babanë e vet, ashtu qysh nuk jeton as ti me personin që e ke burrë. Fakti se ai paralajmëron ndarjen, do të thotë se ju i mungoni njëri-tjetrit dhe se nuk jetoni si burrë e grua. Këtu mungon interesimi juaj për të jetuar bashkë.

Ose ti nuk e merr në Evropë ku jeton me letra ose ai nuk do të jetojë me ty atje...

Kështu, qysh jeni aktualisht, nuk u shoh bashkë.

Gruaja ka ndryshuar...

Jam 42-vjeçar, jetoj në Prishtinë. Ka kohë që nuk e përjetoj ndjenjën e dikurshme me gruan time. Ajo sikur me zor më përgjigjet në kërkesat për intimitet bashkëshortor, me vështirësi përgjigjet në pyetjet e mia dhe nuk është ajo që ka qenë dikur. Po e vërej një ndryshim të madh te ajo, por nuk di pse po ndodh kjo gjë.

Jam shumë i brengosur për këtë gjë...

Përgjigje:

Gruaja jote ka një vit më pak se ti, e kjo do të thotë se jeni gjeneratë e njëjtë.

Kishte shkuar një njeri te mjeku dhe i ankohet mjekut:

"Po më dhemb këtu doktor... Kurrë nuk më ka dhimbtë deri më tani".

"Sa vjeç je?"

"60 vjeç".

"Eh, deri më tani kurrë s'i ke pasur 60 vjet, prandaj edhe të dhemb".

Desha ta ndërlihd rastin me pyetjen tuaj dhe të them se ju deri më tani kurrë nuk i keni pasur 52 vjet. Tani kanë nisur fëmija të marrin vendime dhe ju keni më shumë halle dhe brenga për sjelljen dhe lëvizjet e tyre.

Jetoj me të, por nuk e dua

Jam 50-vjeçare. Jeta ime ka marr formën e vet që nuk duhej ta kishte. Jam martuar qe 32 vjet.

E kam dashur dikë tjetër dhe ende e dua, edhe pse lidhja jonë ishte ndërprerë qyshkur më fejuan për këtë njeri që jam tash, me të cilin jetoj sot. Kurrë nuk kam qenë e lumtur në martesë...

Tash fëmijët janë rritur, dy janë martuar, por jeta ime vazhdon me vështirësitë e veta, shkaku se jam shumë e palumtur me të gjitha. E di se më nuk ka shpresa për asnjë ndryshim, e di se kam ëndërruar

që do t'më lëshojë burri dhe, të paktën, do të isha e lirë prej tij, por kjo nuk ndodhi...

Dua të di, a do t'më përmirësohet shëndeti, sepse kam shumë probleme dhe, pikërisht, kur e lut Zotin për vdekje, ajo nuk vjen?

"E palumtur jam"

Përgjigje:

Lumturia është vetëm një nocion të cilin e përdorin rinia kur janë në kulmin e dashurisë rinore. Nuk ekziston lumturia si realitet, por pjesërisht ka shtrirje te njeriu. Megjithatë, kanë kaluar 32 vjet prej kur ti ke krijuar një jetë të re me një njeri me të cilin ke lindur tre fëmijë.

A ka dikush që mund ta bëjë njeriun më të lumtur sesa fëmija i tij?

Me siguri, jo.

Duhet ta kaloni shikimin te familja dhe te fëmija dhe të kuptoni se lumturinë që e keni ëndërruar nuk do ta gjeni as te ai njeri ashtu qysh keni menduar.

Keni fantazuar shumë, keni pasur shumë iluzione dhe ndër to keni menduar edhe të fluturoni mbi re, por kjo nuk ka ndodhur. Edhe ajo lidhje do i kishte gabimet dhe të metat e veta. Do të dëshiroja që këto që po t'i them unë të të shërbejnë si fakte që t'i kujtosh shpesh dhe ta shërosh shpirtin. Ti ke kaluar në diabet dhe kjo ta vështirëson jetën.

Prandaj, mos krijo probleme për diçka që nuk ke realizuar. Ka qenë vendim i Zotit të madhërishtëm që të ndodhin gjërat në këtë mënyrë dhe duhet të pajtohesh me fatin tënd...

Kujt t'i besoj?

Përshëndetje e dashura magjistare! Si e parashikoni jetën time kur dihet se kam shumë oferta, por nuk di kujt t'i besoj?

Kam qenë në lidhje edhe më herët, por tash nuk di çka të bëj dhe kujt t'i besoj...

"Zeshkania"

Përgjigje:

Para së gjithash, dikujt duhet t'i besoni. Besimi në këtë rast nuk është

diçka që menjëherë u bën me fat, por as mosbesimi nuk është diçka që ua merr fatin. Ju duhet t'u përgjigjeni ofertave, por t'u përgjigjeni me bisedë dhe marrëveshje për të ardhmen.

Pra, besoni në veten tuaj dhe keni bindjen se çdo gjë mund të arrihet edhe përmes komunikimit, nëse personi është i sinqertë. Kur ai është i pasinqertë dhe me qëllime të caktuara, atëherë nuk u bën dobi as dalja, as kalimi.

Pse pas martesës çdo gjë shkon mbrapsht?

E dashura magjistare, unë që u shkruaj jam një i martuar, 38 vjeç. Kam 5 vjet që jam martuar dhe jam shumë në hall. Qëkur u martova mori gjithçka mbrapsht: grindje në familje dhe me bashkëshorten... Akoma nuk kemi fëmijë. Jemi munduar të kemi, por pa rezultat. Çdo derë imja është mbyllur... Nuk më del kësмети as për punë. Me pak fjalë, çdo gjë në lidhje me jetën time është mbrapsht... Ju lutem, më ndihmoni se jam i bindur se kam magji...

"Eduardi"

Përgjigje:

Askush më mirë se ti nuk di që je nën magji. Nëse pacienti shkon te mjeku, ai më së miri e di nëse është mirë apo nuk është, sepse brenda tij ndodh i tërë problemi. Pra, ai është poligoni ku zhvillohet beteja...

Logjikisht, nëse çdo gjë ka qenë mirë, por ka ndryshuar për të keq prej kur je martuar, kjo ka domethënie të mbrapsht. Magjia është një veprim që ndërmerret për ta ndryshuar gjendjen në një shtëpi. Pra, për ta ndryshuar për të keq dhe te ju ka mbështetje ky mendim.

Megjithatë, nuk mund të pohoni me bindje se këtë gjë e ka bërë nusja apo familja e saj. Këtë gjë kanë mundur ta bëjnë edhe në familjen tënde të gjërë apo në rrethin tënd familjar. Por, sidoqoftë, nuk bën të etiketoni

askënd pa fakte, sepse ka te ne shumë zonja që kanë marrë këtë epitet pa pasur asgjë të keqe në shpirtin e tyre...

Në këtë rast, dëmi dhe mëkati janë të mëdha dhe ata që shpifin pa fakte i bartin përgjegjësitë.

Jam duke bashkëjetuar me të fejuarin, por mërziten prindërit e tij

Jam vajzë 21 vjeçe, studente në Prishtinë. Jam nga Gjakova. Kam të dashur me të cilin jemi duke bashkëjetuar qe një vjet. Kemi shpesh mosmarrëveshje, por e di se më do shumë.

E kam një brengë, sepse po mërzitën prindërit e tij...

"Pa shifër"

Përgjigje:

Ju nuk e keni bërë zyrtare lidhjen tuaj. Nuk jeni fejuar akoma dhe duhet ta dalloni fejesën dhe aktin e fejesës me një mbyllje në banesë me qira larg rrethit tuaj.

Ç'është fejesa duhet t'ua sqaroj, sepse ka shumë pyetje me këtë tematikë dhe, mjerisht, koha pos sjell gjëra të papritura, për çka prindërit e tij edhe mërzitën dhe unë i kuptoj plotësisht ata, se djali i tyre nuk është duke vepruar në rregull me ty...

Fejesa është akti i zyrtarizimit të një lidhjeje. Është para-martese, është një tubim i njerëzve të ftuar nga djali që fejohej, por edhe familja e vajzës fton të afërmit e vet.

Pse ndodh kjo?

Familja e djalit i fton të afërmit, miqtë dhe dashamirët, bën fejesë dhe në atë tubim bëhet botërisht e ditur se filani e filania janë fejuar. Mesiti jep dorën, që do të thotë se me pajtim familjar bëhet bashkimi. Në familjen e vajzës, gjithashtu, ftohen më të dashurit e saj, ku bëhet publike fejesa.

E, a ka diçka prej këtyre gjërave që ju e keni kryer?

Asgjë! Jeni takuar në Prishtinë, jeni njohur, mund të flini së bashku në banesë nja disa vjet e më pas secili

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

në drejtimin e vet...

Asnjëri prej jush nuk ka të drejtë morale e as ligjore të kërkojë prej palës tjetër llogari.

Kjo që bashkëjetoni nuk është fejesë, por një kalim i kohës së shfrenuar.

Ç'qëllim ka ish - i dashuri im?

Jam një vajzë 27 vjeçe, jetoj në rrethin e Ferizajt. Kam pasur një të dashur, me të cilin kemi qenë bashkë 7 vjet, por ai u martua.

Ndërkohë, pasi u martua, shkoi jashtë, ku i ka bërë letrat nga gruaja e tij.

Kemi vuajtur shumë të dy dhe kemi derdhur lot.

Pasi u martua, pas një kohe më është lajmëruar dhe më ka ofruar martesë, duke më premtuar besnikëri.

Pra, jam pa tekst zonja magjistare. Jam e humbur prej kur më tha të martohemi...

Çka më preferon?

"E humbura"

Përgjigje:

Unë kam mendim negativ sa i përket ribashkimit tuaj me martesë.

Mund të ndodhin shumë gjëra të pakëndshme nëse ju lidhni përsëri.

E para, ribashkimi juaj me martesë do të qonte në ndarjen e tij nga gruaja, që ia ka bërë letrat atje;

E dyta, është problem t'i mbetën letrat atij;

E treta, madje më e rëndësishmja, është çrregullimi ndër familjar, e që mund të prodhojë krejt situatë tjetër në jetën tuaj.

Pra, këshilla ime është: kërkoje fatin e ri dhe harroje atë person! Në kohën e duhur nuk të ka bërë zgjidhje, andaj nuk e ke të sigurt as tani a do të të bëjë zgjidhje a jo...

Cilat janë femrat më të rrezikshme sipas Horoskopit?

Femrat janë qeniet më komplekse. Ato janë sa të dashura, të sjellshme e të mira, po aq edhe misterioze. Ka disa femra prej të cilave duhet të kemi kujdes, sepse konsiderohen të fshehta dhe të rrezikshme.

DASHI

Nuk është sekret për asnjë që Dashi është kokëfortë. Mos u nxitoni ta hapni zemrën tuaj dhe të tregoni sekretet tuaja. Në fund të fundit, Dashi shumë lehtë përdor pikat e dobëta nëse duhet të fitojë një luftë kundër jush.

LUANI

Gratë e Luanit nuk i durojnë dot intrigat. Por, në të njëjtën kohë me këto femra nuk duhet të humbisni vëmendjen tuaj. Ato mund të sulmojnë në çdo kohë. Ato kërkojnë admirim të vazhdueshëm nga të tjerët.

VIRGJËRESHA

Femrat që i përkasin shenjës së Virgjëreshës janë shumë të turpshme, por ka diçka tërheqëse në to. Ndonjëherë ato mund të tregojnë kundërshtimin e tyre, sidomos kur dikush dëshiron t'i korrigjojë ato, ose u thotë atyre të bëjnë diçka.

Në fund të fundit, ka vetëm dy mendime për to: mendimin e virgjëreshës dhe mendimin e gabuar.

AKREPI

Femrat e Akrepit janë mike shumë të mira. Por, nëse e keni kaluar rrugën e

Akrepit, atëherë mos prisni mëshirë.

Ajo do ua kthejë jetën tuaj në një ferr të vërtetë dhe do të shikojë vuajtjet tuaja me interes.

BINJAKËT

Personalitete shumë interesante, por shpesh kanë një personalitet të dyfishtë. Ndonjëherë ato janë shumë interesante dhe, në raste të tjera, mund të gënjejnë, duke u parë drejt e në sy dhe nuk skuqen fare.

E, kjo shpesh ndikon në ata që nuk janë indiferentë ndaj binjakëve.



KOSOVA AIRLINES eurokoha

flyksa.com | eurokoha.eu



Atë që nuk e ka Kosova e ka Hysni Rexhaj!

Hysni Rexhaj, nga Gjakova, jeton me 2000 kafshë të egra! Ka kopsht zoologjik që nuk e ka Kosova!

55-vjeçari, Hysni Rexhaj, nga Gjakova, njihet edhe me pseudonimin "Mogli i Kosovës", i cili jeton me 2000 kafshë të egra!

Hysni Rexhaj që prej moshës 5-vjeçare ka pasur pasion të merrej me botën e egër, duke nisur fillimisht me pëlumba dhe shqiponja.

"Nisa si pasion fëmije, duke u bërë me kafshët një familje", tha Hysni ditë më parë për një media televizive. Edhe gjatë regjimit serb ai nuk e harroi këtë pasion, ku pas mbarimit të shërbimit ushtarak kafshët në fermën e tij shtoheshin vazhdimisht dhe mund të thuhet, lirisht, se ai e ka një kopsht zoologjik, të cilin nuk e ka Kosova.

2000 KAFSHË NË "KOPSHTIN ZOOLOGJIK" TË HYSNIUT

"I kam mbi 2000 kafshë në fermën time nga të gjithë llojet, duke përfshirë ujkun, majmunin, dhelprat, gjarpërinjtë, strucat a shqiponjat", tregon ai.



Sidoqoftë, "kopshtin zoologjik" të Hysniut e vizitojnë shumë adhurues të kafshëve të egra nga mbarë Kosova, të cilët mbesin të mahnitur nga pasioni i tij që është bërë shumë popullor në mediet e huaja, falë një fotoje virale, ku duket Hysniu teksa e futë kokën në gojën e ujkut!

"Më kanë vizituar edhe mediet më prestigjioze në botë dhe më kanë intervistuar", thotë Hysni.

Hysni, po ashtu, tregon se këtë dhunti ia ka dhënë Zoti dhe se i është shumë mirënjohës atij.

Që fëmijë kishte ëndërruar të mbante ujqër në oborrin e shtëpisë dhe sot ëndrra e tij është bërë realitet.

Dhe, me kohë pasioni i është bërë profesion, meqë në rastet kur njerëzit

gjejnë kafshë të ndryshme të egra në ambientet e shtëpive të tyre dhe duan t'i heqin, kontaktojnë Hysniun, i cili u vjen në ndihmë për t'i zhvendosur, pa rrezikuar askush jetën, duke u bërë kështu një misionar që mendon për kafshët dhe botën e egër.



anaderm

Spitali i Specializuar për Kirurgji Estetike dhe Plastike

Shkencë. Art. Etikë.

FYTYRA & QAFA

- Operimi i Hundës (Rhinoplasty)
- Operimi i Qepallës
- Operimi i Veshit (Otoplasty)
- Ngritja e Vetullave
- Ngritja e Qafës
- Korigjimi i buzës së çarë, hundës dhe qiellzës së butë
- Korigjim i Nofullës
- Ngritja e Fytyrës - Facelift

GJOKSI

- Zmadhimi i Gjirit - me implante MENTOR
- Ngritja e Gjinjëve
- Zvogëlimi i Gjirit
- Zvogëlimi i Gjirit tek Meshkujt

OBESITETI

- Baloni Gastrik - Spatz³
- Gastric sleeve
- Dietë e personalizuar

TRUPI

- Abdominoplastika
- Liposuction
- Formimi i trupit me definim të lartë
- Ngritje Krahu (brachioplasty)
- Ngritja e kofshes
- Ngritja e mollaqit - vitheve
- Rritja e mollaqit - vitheve
- Labioplastika - vaginoplastika
- Aplikimi i expanderëve - zmadhuesve

PROCEDUARA MINORE

- Heqja e Moleve / Nishanëve
- Heqja e Tatuazheve dhe Mbresave

MBJELLJA E FLOKËVE

- Mbjellja e flokëve
- Mbjellja e mjekrës
- Mbjellja e vetullave

EKIPI NDËRKOMBËTAR NË BASHKËPUNIM ME EKIPIN VENDOR I JAPIN KUPTIM TË BUKURËS



DR. SELAHATTIN
ÖZMEN



DR. NEDŽAD
RUSTEMPAŠIĆ



DR. GUIDO
MARONATI



DR. IVO
DŽEPINA



DR. ŞÜKRÜ
YAZAR



DR. NECDET
UÇAR



DR. YUNUS
YAVUZ

+383 (0) 45 707 733 | +383 (0) 45 707 744 | +383 (0) 43 707 744

Rr. Zef Jubani – Veternik, 10000 Prishtinë, Kosovo

KENDA

CENTER

BY SHKENDA DUBOVA

Përforco veten.

Përkushtimi i shëndetit përfshin mirëqenien dhe cilësinë e jetës, duke reduktuar stresin dhe duke rritur nivelin e energjisë.



Relaksohu.

Relaksimi ndihmon për të reduktuar ankthin dhe për të përmirësuar gjumin. Duke përfshirë teknikat e relaksimit në rutinën tënde të përditshme mund të ketë një ndikim pozitiv në shëndetin tënd mental dhe fizik.



Detoksifikohu.

Procesi i heqjes së toksinave nga trupi ka avantazhe duke përmirësuar tretjen, duke rritur energjinë, duke pastruar lëkurën dhe po ashtu duke humbur peshë.



Balanco Shëndetin.

Balancimi i shëndetit është i rëndësishëm për të pasur një jetë të shëndetshme. Arritja e balancës do të thotë të kemi kujdes për fizikun, por jo vetëm.





SHERWOOD
Resorts and Hotels



GREENWOOD
Resorts and Hotels

feel the legend

SHERWOOD
exclusive kemer

SHERWOOD
exclusive Lara


SHERWOOD
Dreams Resort




SHERWOOD
Premio Hotel

GREENWOOD
Kemer Resort

GREENWOOD
Suites Resort

 [sherwoodresorts](https://www.instagram.com/sherwoodresorts)

 [greenwoodhotels](https://www.instagram.com/greenwoodhotels)

www.sherwoodhotels.com.tr

www.greenwoodhotels.com.tr